

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË MONEDHAVE ME VLERË NOMINALE
2 DENARË

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim monedhat me vlerë nominale 2 denarë me shenjë të emetimit „2018“ dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetimin dhe karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale 2 denarë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 202/16), duke filluar nga data 15 prill i vitit 2018.

2. Me lëshimin në qarkullim të monedhave nga pika 1 e këtij vendimi, paralelisht në qarkullim në operacionet me para të gatshme në Republikën e Maqedonisë do të jenë edhe monedhat me vlerë nominale 2 denarë, të emetuara në bazë të Vendimit për emetim, vlerë nominale dhe karakteristika themelore të monedhave dhe kartëmonedhave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 25/93).

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.

Nr.V. 02-15/VI-7/2018
29 mars viti 2018
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov